

VENDIM
Nr.867, datë 12.8.2009

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË
SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 3 shtohet emërtimi:
“- Avokat shteti, pranë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.”.
2. Në pikën 4 shtohen emërtimet:
“- Kryetar i zyrës vendore në Avokaturën e Shtetit.
- Jurist, pranë zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha